

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		26/08/	20 20
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01-	35122	

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>25.08.2020</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: <u>4</u>
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak <u>X</u> Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak <u> </u>
Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>16</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☒ <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da ☒ Nënkyetari Jo / Ne ☐
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me 25.06.2020; 2. Njoftim për situatën epidemiologjike në Komunën e Drenasit; 3. Njoftim me përgatitjet e ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor; 4. Të ndryshme. <i>Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:</i>

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur mbledhjen e katërt të rregullt për këtë vit të cilën e kryesoi nënkryetari i Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi.

Të pranishëm ishin shumica e anëtarëve e KKSBB-së.

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur më 25.06.2020 u miratua unanimit, pa ndonjë vërejtje.

Nënkryetari i Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi, i informoi të pranishmit me situatën aktuale sa i përket të infektuarve dhe gjendjen e tyre shëndetësore, numrin e të shëruarve dhe të vdekjeve në Komunën e Drenasit si pasojë e pandemisë. Drejtori i Inspeksionit Milaim Hajdari i njoftoi të pranishmit për punën e kësaj drejtorie gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht në respektim të zbatimit të rekomandimeve të IKSHB-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë si dhe për çështje tjera që bien në fushëveprimin e kësaj drejtorie.



Për pikën e tretë, drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Muhamet Gjoka, i njoftoi të pranishmit me skenarët e propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kthimin e nxënësve në bankat shkollore. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marrë të gjitha masat që mësimi të fillojë sipas skenarit të parë që nënkupton mësimi me prezencë në institucionet parashkollore dhe shkolle, me masat parandaluese. Në rast të infektimit pastaj do të vepohet në përputhje me situatën me skenarin B dhe C. Gjithashtu, kjo drejtori, pas konsultimeve me drejtorët e shkollave, është kujdesur që shkollat të furnizohen me pompa spërkatëse dhe me klor, në mënyrë që pas trajnimit të stafit për përdorim të tyre, shkollat të dezinfektohen dy herë në ditë si dhe për furnizim me maska dhe material të nevojshëm higjienik në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të marrin pjesë në procesin mësimor. Ndërsa nënkryetari Hasi sqaroi që në zonat rurale numri i nxënësve është më i vogël për dallim në qendra dhe nëse shfaqen raste të infektimit do të kalohet në skenarët tjerë respektivë sipas situatës.

Të pranishmit u interesuan dhe u njoftuan edhe për modalitetet e transportit, për respektimin e distancës nga ana e operatorëve transportues.

Për pikën të ndryshme nuk pati diskutime.


Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSBB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)



Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovi



nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 26.08.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSBB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSBB-së.